

VENDIM
Nr.640, datë 28.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, NË KOMUNËN E FARKËS, QARKU TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në Komunën e Farkës të qarkut të Tiranës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës së Farkës, qarku Tiranë.
 3. Pasuritë në sipërfaqen prej 20400 (njëzet mijë e katërqind) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 50 734 800 (pesëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Farkës, planifikuar në buxhetin e vitit 2010.
 5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Farkës.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Farkës, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 20400 (njëzet mijë e katërqind) m² tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Farkës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Farkë e qarkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE”, NË KOMUNËN E
FARKËS, QARKU TIRANË

Nr	Emër, mbiemër	Sip.arë	Çmimi lekë	Vlera lekë	Dokumenti i pronësisë	Zona kadastrale
1	Ruzhdi Palushi	20400	2487	50734800	Certifikatë pronësie	334/6
	Totali			50 734 800		